

VENDIM
Nr.367, datë 27.3.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS
ZHARRËZ TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Zharrëz të qarkut të Fierit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zharrëz të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.562, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Zharrëz të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Zharrëz për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna: Zharrëz

Lidhja 1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14-18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
8-13	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
19-23	Varreza publike	Në pronësi
53-62	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
89-98	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
63	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
100,101	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e furnizimit me ujë	Në pronësi
24-52	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
75,78,81,83,85	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
76,77,79,80,82,84,86,87,88,124,127,132,135,140,141,158,160,163,177	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi